



Prishtinë, 31 maj 2024  
Kodi i ZRRE-së: V\_2138\_2024

## Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

### Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: ZRRE/DMK\_V\_2537\_04\_24 i datës 30.04.2024;
- Ankesa e konsumatorit e datës 28.05.2024.

në seancën e mbajtur më datë 31.05.2024 nxori këtë:

### V E N D I M

- I. REFUZOHET si e pabazuar ankesa e konsumatorit D.Z nga fsh, Ruhot, Komuna e Pejës, e parashtruar ndaj vendimit të DMK-së;
- II. MBETET në fuqi, vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me nr. ZRRE/DMK\_V\_2537\_04\_24 i datës 30.04.2024.
- III. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit të tij nga Bordi i ZRRE-së, dhe i njëjti do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

### A r s y e t i m

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me datë 30.04.2024 ka marrë Vendim me nr. ZRRE/DMK\_V\_2537\_04\_24 me të cilin e ka refuzuar ankesën e konsumatorit, përmes së cilës i kishte kontestuar faturat e energjisë elektrike, me njehsorin elektrik nr. 20032963 për shkak të dyshimit në lexim dhe faturim jo të saktë.

I pakënaqur me Vendimin e DMK-së, konsumatori D.Z brenda afatit ligjor ka paraqitur Ankesë në Bordin e ZRRE-së, për këto shkaqe:

- Vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike;
- Konsumatori pretendon që është mashtruar gjatë konstatimit të gjendjes faktike sa i përket leximit;
- I propozon Bordit që të aprovohet ankesa si e bazuar, ashtu që të korrigjohet fatura për periudhën 12/2023.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 31.05.2024 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuara nga palët në kontest, si dhe vendimin e Departamentit për



Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji ka administruar këto prova: Ankesën e ankuesit të datës 28.05.2024; Vendimin e DMK të datës 30.04.2024; Ankesën e konsumatorit në KESCO të datës 15.01.2024; Përgjigjën e KESCO-s të datës 08.02.2024, Ankesën e konsumatorit në DMK të ZRrE-së të datës 26.02.2024; Procesverbalin e inspektimit të dt. 16.01.2023; Rrjedhën e energjisë elektrike, Transaksionet dhe Listat e Leximit.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankuesit/konsumatorit është e pabazuar, sepse:

Departamenti i faturimit në KESCO me datë 30.12.2023 i ka dërguar konsumatorit faturën mujore të energjisë elektrike për periudhën dhjetor 2023 me **1,478 kWh** apo e shprehur në vlerë financiare prej **137.85 €**. Me datë 15.01.2023 konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në KESCO duke kërkuar që ti behet ri shqyrtimi i faturës për periudhën dhjetor 2023, për shkak të dyshimit në matje, leximit dhe faturimit jo të saktë të njehsorit elektrik nr. 20032963. Me datë 08.02.2024 Departamenti për Konsumator në KESCO i është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar ankesën e tij bazuar në pasqyrën e rrjedhës së energjisë elektrike, Procesverbalit të inspektimit nr. 2053064 të dt. 16.01.2024, transaksioneve si dhe listat e leximit.

Bordi i ZRrE, pas analizimit dhe administrimit të provave materiale si në shkresat e lëndës, ka gjetur se, duke u bazuar në Procesverbalin e inspektimit të dt. 16.01.2024, pasi që konsumatori ka parashtruar ankesë në KESCO, punëtorët e autorizuar të KEDS e kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit ku kanë evidentuar gjendjen e shpenzimeve të regjistruara në njehsorin elektrik me nr. 20032963 me TL = 18938 kWh dhe TU = 14325 kWh. Nga analizimi i këtij procesverbali, Bordi ka gjetur se, DMK me të drejtë ka konstatuar faktin se, kilovatët e evidentuar në këtë procesverbal dhe shpenzimet e regjistruara, përputhen plotësisht me shpenzimet e faturuar në CPP për periudhën 12/2023.

Bordi po ashtu ka analizuar me kujdes edhe Rrjedhën e Energjisë Elektrike dhe Listat e Leximit për këtë konsumator dhe ka gjetur se, konsumatori ka lexim dhe faturim të rregullt të shpenzimeve mujore dhe se leximi i shpenzimit të konsumatorit është bërë me pajisje të dorës (HHU) përmes Sondës dhe se lexuesi i KEDS-it në asnjë rast nuk ka evidentuar se nuk ka qasje në leximin e shpenzimeve mujore apo që njehsori elektrik është i dëmtuar në çfarëdo forme përfshi edhe dyshimin në mos matje të saktë. Bordi ka shqyrtuar me kujdes gjetjet e DMK-së, të evidentuara në vendimin e kontestuar se, nga analizimi i listave të leximit dhe rrjedhën e energjisë elektrike, është konstatuar se, konsumatorit për periudhën dhjetor 2023 nuk është faturuar me shpenzimet reale mujore, për shkak se, leximi i periudhës nëntor 2023 është bërë me datë 21.11.2023, kurse për periudhën kontestuese, është bërë me datë 30.12.2023, e që i bie 9 ditë me vonësë. Më tej, janë analizuar edhe shpenzimet e mëhershme të konsumatorit dhe është gjetur se, konsumatori për periudhën kontestuese, ka ndryshim krahasuar me shpenzimet e periudhës së njëjtë të vitit paraprak dhe sipas rrjedhës së energjisë vërtetohet se, shpenzimi i konsumatorit në periudhat e mëhershme është si vijon: periudha 12/2020 është 696 kWh/muaj, periudha 12/2021 është 629 kWh/muaj, periudha 12/2022 është 1,815 kWh/muaj, kurse për periudhën kontestuese 12/2023 është 1,478 kWh/muaj. Mbi këtë bazë, më të drejtë është konstatuar se, për këtë periudhë, nuk ka lexim dhe faturim të rregullt mujor, e që është në kundërshtim





me nenin 28 par. 1 dhe 2 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, si vijon: “1. Furnizuesi është i detyruar të sigurojë që konsumatorët të jenë të faturuar për energjinë e shpenzuar r dhe për tarifën tjera, sipas strukturës tarifore të përcaktuar dhe në përputhje me llojin e tarifës të dakorduar me Konsumatorin (nëse është e aplikueshme). 2. Faturimi i energjisë së shpenzuar zbatohet për çdo periudhë të faturimit duke u bazuar në të dhënat e lexuara nga njehsori dhe të mbledhura nga Operatori i Sistemit ose Furnizuesi ashtu siç është rënë dakord në kontratën për furnizim, ose me tarifa të miratuara nga Rregullatori për konsumatorët që gëzojnë të drejtën e shërbimit univerzal dhe furnizuesit të mundësisë së fundit”.

Më tej, në vendimin e kontestuar, është sqaruar se, shpenzimet e konsumatorit për periudhën 12/2023 janë lexuar me datë 30.12.2023, kurse për periudhën paraprake 11/2023 me datë 21.11.2023, pra me një diferencë prej 9 ditësh, në kundërshtim me nenin 3 par. 3.1 të Procedurës së Leximit dhe Faturimit të Konsumatorëve Tarifor, e ku thuhet se: “Leximi i njehsorëve, duhet të përfshijë periudhën një mujore të shpenzimit të energjisë. Data e leximit të çdo konsumatori do të jetë e njëjtë si e leximit paraprak me maksimum +2 ditë punë. Në rast se data e leximit dhe toleranca e lejuar (2 ditë) i bie të jetë në fund të javës ose gjatë festave shtetërore, atëherë periudha kohore e shpenzimit të energjisë elektrike mund të shkurtohet ose të zgjatet për aq sa zgjasin këto festa”. Po ashtu, në vendimin e kontestuar, konsumatorit i janë shpërndarë kilovatët e faturuar për periudhën dhjetor 2023 dhe janar 2024, dhe është konstatuar se konsumatorit nuk i takon korrëgjim financiar.

Bordi ka shqyrtuar me kujdes pretendimet e tjera ankimore të konsumatorit, dhe thekson se, pjesa e diferencës së leximit prej 8 ditësh, është lëshim teknik i DMK-së, dhe në asnjë mënyrë nuk mund të interpretohet ndryshe. Konsumatorit, në një tjetër paragraf, i është sqaruar se vonesa në lexim është bërë për 9 ditë, dhe se, pavarësisht këtij lëshimi të ndërmarrjes, e i cili edhe është evidentuar si i tillë, konsumatorit nuk i takon korrëgjim financiar.

Tutje, Bordi thekson se, duke u bazuar në nenin 5 – Furnizimi me Energji elektrike – të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji Elektrike, të gjithë konsumatorët e kanë për obligim që të paguajnë për energjinë elektrike të shfrytëzuar sipas kontratës për furnizim me energji të lidhur me furnizuesin e energjisë, si dhe për tarifën për shfrytëzim të sistemit të miratuara nga ZRrE-ja”, andaj konsumatori e ka për obligim që të paguaj energjinë elektrike të cilën e ka shpenzuar.


Konsumatori më tej ka theksuar se, përveç faturimit të periudhës 12/2023 nuk ka lexim të rregullt mujorë (30 ditor), në vendimin e kontestuar është konstatuar se faturimi i periudhave tjera është në përputhje me legjislacionin në fuqi, përkatësisht, Procedurës së Leximit dhe Faturimit të Konsumatorëve Tarifor dhe ky pretendim si i tillë nuk qëndron.

Bordi i ZRrE, gjithashtu ka konstatuar se konsumatori në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se e ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar, pa ofruar prova të arsyeshme.



**Këshillë Juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimi të Vendimit ose nga data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.


**Bordi i ZRRE-së:**

  
Ymer Pejzullahu, Kryesues

  
Lutfije Dervishi, Anëtare

  
Gani Buçaj, Anëtar

  
Arta Isufi, Anëtare

  
Adnan Preniqi, Anëtar

**Vendimi u dërgohet:**

- KESCO-s,
- Konsumatorit **D.Z** dhe
- Arkivit të ZRRE-së.